UDHËZIM
Nr. 15, datë 13.6.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1457, DATË 28.7.2009, "PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË FORMIMIT PROFESIONAL", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të neneve 8 dhe 23, shkronja "c", të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 20, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikës 5, kreu II dhe pikës 4, kreu IX, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta", si dhe në zbatim të planit të veprimeve të "Strategjisë së punësimit dhe aftë-sive 2014–2020",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 1457, datë 28.7.2009, "Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 16 shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:

"17. Subjektet e licencuara raportojnë në mënyrë periodike, çdo 3 (tre) muaj, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit të dhënat, për: numrin e të regjistruarve, emrat e tyre sipas librit të amzës, kurset për të cilat marrin formim profesional dhe janë certifikuar.

a) Të gjitha subjektet e licencuara duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të dhënat sipas pikës 17. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit krijon një databazë të të gjithë personave që kanë kryer kurs formimi profesional, duke filluar nga janari 2016 e në vazhdim.

b) Në rast se subjektet e licencuara nuk respektojnë detyrimin e përcaktuar sipas pikës 17/a të këtij udhëzimi, do të merren masa deri në revokimin e licencës.

2. Pika 17 bëhet pika 18.

3. Kudo në udhëzim, emërtimi "... Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta...", zëvendësohet me "... Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi